



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.96

20 korrik

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.452, datë 22.6.2011	Për miratimin e Raportit të Dytë Kombëtar Periodik, në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, për periudhën 2004-2010..... 3907
Vendim i KM nr.467, datë 29.6.2011	Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së tipit C/SP..... 3907
Vendim i GJK nr.31, datë 5.7.2011	Me objekt: 1. Pranimi i padisë dhe shpallja, si e papajtueshme me Kushtetutën, e moslirimit të pronës. 2. Prishjen e vendimit nr.00-2008-1033, datë 16.10.2008 të Gjykatës së Lartë. 3. Prishjen e vendimit nr.656, datë 6.6.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë. 4. Prishjen e vendimit nr.1914, datë 6.4.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 5. Detyrimi i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë dhe i komisariatit përkatës të Policisë Tiranë për të liruar pronën truall 2000 m ² të ndodhur në Mëzez (Tiranë), e cila është në pronësi të kërkuesit. 6. Detyrimi i Qeverisë Shqiptare për të dëmshpërblyer kërkuesin, për shkak të dëmit pasuror të ardhur si pasojë e moslirimit të pronës së sipërpërmendur, me vlerën prej 10.965 milionë euro. 7. Shfuqizimi: i dispozitave të mëposhtme të nenit 128 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”: “Ligji nr.7498, datë 5.7.1991 “Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë” (i ndryshuar), si dhe akte të tjera normative në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e Policisë, por që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen”..... 3917
Rregullore e MPPT nr.2638, datë 10.6.2011	Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhorë 3922

VENDIM
Nr.452, datë 22.6.2011

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË DYTË KOMBËTAR PERIODIK, NË KUADËR TË
PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE, PËR
PERIUDHËN 2004-2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Raportit të Dytë Kombëtar Periodik, në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, për periudhën 2004-2010.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.467, datë 29.6.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURAVE
PËR PAJISJEN, REFUZIMIN, RIPËRTËRITJEN DHE ANULIMIN E LEJES
SË TIPIT C/SP**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 48, pika 2, 60, pika 2, dhe 67, pika 1 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit C/SP, si sportist, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

a) ka një kontratë pune me një punëdhënës/klub sportiv, në përputhje me profesionin e tij;
b) ka hyrë dhe qëndron në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, që do të thotë me vizë, të llojeve të përcaktuara në nenet 13 e 14 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

2. Të huajt i ripërtërihet leja e punës e tipit C/SP, si sportist, nëse:

a) ka një kontratë pune të vlefshme, në përputhje me profesionin e tij si sportist në rajonin gjeografik, ku ka përfituar lejen e mëparshme të punës, por jo domosdoshmërisht, me punëdhënësin/klubin sportiv, që ka përfituar lejen e parë të tipit C/SP;

b) është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) për punësimin e tij është marrë federimi nga federata përkatëse sportive, pas kërkesës së paraqitur nga klubi sportiv.

3. Kërkesa për pajisjen e të huajt me leje pune të tipit C/SP, si sportist, bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi/klubi sportiv me të cilin i huaji ka një kontratë pune;

c) personi i autorizuar nga punëdhënësi/klubi sportiv.

4. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për pajisjen e të huajt, për herë të parë, me leje pune të tipit C/SP, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajit, me të dhënat personale, sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) vendimin e gjykatës për regjistrimin e personit juridik ose ekstraktin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për punëdhënësin/klubin sportiv, ku ai do të punësohet;

c) kopjen origjinale të kontratës individuale të punës;

ç) kopjen e pasaportës;

d) miratimin me shkrim të federatës përkatëse të sportit;

dh) autorizimin nga punëdhënësi/klubi sportiv për personin e autorizuar;

e) pesë fotografi.

5. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për pajisjen e të huajit me leje pune të ripërtëritur të tipit C/SP, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajit, me të dhënat personale, sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) kopjen e kontratës individuale të punës;

c) autorizimin nga punëdhënësi/klubi sportiv për personin e autorizuar;

ç) pesë fotografi;

d) miratimin e federatës përkatëse sportive;

e) fotokopjen e lejes paraardhëse të qëndrimit.

6. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi:

a) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrës përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, ushtron veprimtarinë ekonomike, dhe nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës.

7. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, kur kërkesa paraqitet pranë tyre, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 4 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

8. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi:

a) verifikon shlyerjen e detyrimeve në organet tatimore, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit/klubit sportiv, pranë të cilit do të punësohet;

b) kërkon nga drejtoritë rajonale të inspektimit në punë/zyrat vendore të inspektimit në punë një vlerësim, ku të evidentohet nëse punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet i huaji, ka zbatuar legjislacionin e punës ose ka shlyer shkeljet e konstatuara në aktin e fundit të inspektimit në punë.

9. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit e pajis të huajin, për herë të parë, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, me leje pune njëvjeçare të tipit C/SP:

a) nëse dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo pas plotësimit të tij nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, brenda afatit të përcaktuar;

b) kur përmbushen kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 8 të këtij vendimi.

10. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi.

11. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit C/SP punëmarrësit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 8 të këtij vendimi, ose është në kushtet e parashikuara në pikën 21 të këtij vendimi.

12. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, kjo e fundit, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, ia përcjell dokumentacionin drejtorisë, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

13. Drejtoria që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e përcjell dokumentacionin e paraqitur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrën përkatëse të punësimit, sipas kompetencës territoriale, që ato kanë.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për pajisjen/refuzimin të huajt të lejes së punës të tipit C/SP ndjek procedurat e përcaktuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 11 të këtij vendimi.

15. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëpërmjet drejtorisë, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përcjell në Ministrinë e Punëve të Jashtme njoftimin me shkrim për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit C/SP.

16. Ministria e Punëve të Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës të të huajt, për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit C/SP.

17. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit C/SP, paraqesin 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese, kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi:

a) në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, ushtron veprimtarinë ekonomike;

b) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik.

18. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit C/SP apo refuzimin e saj, brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, ndjek procedurat e parashikuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 11 të këtij vendimi, ndërsa vlerësimi për kriteret dhe dokumentacionin bëhet sipas përcaktimeve në pikat 2, 5, 8 e 21 të këtij vendimi.

19. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit C/SP apo refuzimin e saj, për të huajt, të cilët kanë përfutuar leje pune, sipas ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, ndjek procedurat e parashikuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 11 të këtij vendimi, ndërsa vlerësimi për kriteret dhe dokumentacionin bëhet sipas përcaktimeve në pikat 2, 5, 8 e 21 të këtij vendimi. Afati i vlefshmërisë së lejes së ripërtëritje të punës për sportistët është njëvjeçar.

20. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës për ripërtëritjen e lejes së mëparshme të punës të tipit C/SP, e pajis të huajin me dokumentin zëvendësues të lejes së punës, sipas përcaktimeve të nenit 46 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

21. Të huajt i refuzohet lëshimi i lejes së punës e tipit C/SP apo ripërtëritja e saj edhe nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në nenin 63 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

22. Të huajt i anulohet leja e punës e tipit C/SP, nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 64 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pasi njoftohet nga autoritetet shtetërore përgjegjëse për vërtetimin e njëres nga situatat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 64 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, merr vendim për anulimin e lejes së punës.

23. I huaji, të cilit i refuzohet ose anulohet leja e punës e tipit C/SP, ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 65 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

24. Leja e punës e tipit C/SP përfundon, nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

25. I huaji, i cili pajiset, për herë të parë, me leje pune të tipit C/SP, para marrjes së lejes së punës detyrohet të paguajë tarifën prej 6 000 (gjashtë mijë) lekësh.

26. I huaji, të cilit i ripërtërihet, për herë të parë, leja e punës e tipit C/SP, para marrjes së lejes së punës detyrohet të paguajë tarifën prej 3 000 (tre mijë) lekësh.

27. Drejtorja, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit, për dhënien e lejes së punës.

28. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR-KËRKESË PËR LËSHIMIN E LEJES SË PUNËS

Ju lutemi plotësoni formularin e mëposhtëm për lëshimin e lejes së punës, e cila do t'ju lëshohet, brenda.....ditë pune, nëse përmbushen të gjitha dispozitat e ligjit.....

APPLICATION FORM FOR ISSUING THE WORK PERMIT

Please complete the following form in to obtain a Work Permit which will be issued to you within...working days, if any of the relevant clauses of the Law....are fulfilled

SEKSIONI 1. TË DHËNA MBI PERSONIN QË PARAQET KËRKESËN SECTION 1. ABOUT THE PERSON SUBMITTING THE REQUEST

Kjo kërkesë paraqitet:

The request is to be submitted:

Personalisht

In person

Nga përfaqësuesi i autorizuar

Authorized representative

Nga punëdhënësi

Employer

Emri : _____
First Name

Mbiemri : _____
Last Name

Emri i babait : _____
Father's Name

Shtetësia : _____
Citizenship

Jeni shtetas i Bashkimit Europian?
Are you national of the European Union?

Po Jo

Datëlindja : _____
Date of Birth (datë, muaj, vit)
(day, month, year)

Vendlindja : _____
Birthplace (shtetas, rajoni, komuna)
(century, region, commune province)

Shtetësia : _____
Citizenship

Kombësia (nëse është e rëndësishme) : _____
Nationality (if relevant)

Gjinia : Mashkull Femër

Gender : Male Female

Gjendja civile : I/e pamartuar I/e martuar I/e divorcuar
Marital Status : Single Married Divorced

A keni pasur më parë një leje pune shqiptare? Po Jo

Have you ever been issued an Albanian Work Permit?

Telefon : _____

E-mail : _____

Mailing address

Pasaportë E zakonshme Shërbimi Diplomatike

Passport Ordinary Service Diplomatic

Dokument tjetër udhëtimi i njohur nga Republika e Shqipërisë si i barasvlershëm:

Other Travel Documents Recognized by the Republic of Albania

Data e skadimit të vlefshmërisë së pasaportës

Data of Passport Expiry

Lëshuar nga : _____

Issuing authority:

Persona në ngarkim në vendin e origjinës:

Family members in charge in the country of origin

Bashkëshort/e Fëmijë të mitur Prindër

Spouse Children Parents

Data e hyrjes së fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë përmes pikës së kontrollit të kalimit të kufirit (PKKK) : _____

Last Entry Date to Albania

Through Border Checkpoint

SEKSIONI 2: TË DHËNA MBI VIZËN
SECTION 2: VISA DETAILS

Data e hyrjes së fundit në Shqipëri : _____
Last entry Date of Albania
Pika e kalimit të kontrollit kufitar : _____
Border Checkpoint
Numri i vizës : _____
Visa Number
Tipi i vizës : _____
Type of Visa
Me një hyrje : _____
Number of Entries (1)
Me shumë hyrje (Multiple) : _____

Shënime/motivi i vizës së hyrjes : _____
Remarks/Reason/Motive of the Entry Visa
Kohëzgjatja e vizës : _____
Duration of Stay
E vlefshme nga : _____
Valid from (datë, muaj, vit)
(day, month, year)

Deri më : _____
Until (datë, muaj, vit)
(day, month, year)

SEKSIONI 3. TË DHËNA MBI STATUSIN E KANDIDATIT
SECTION 3. ABOUT CANDIDATES STATUS

Punëmarrës/e
Employee
Punëdhënës/e
Employer
I/e vetëpunësuar/e
Self-employed
Investitor/e
Investitor

SEKSIONI 4. TIPI I KËRKESËS
SECTION 4. TYPE OF THE REQUEST

Leje pune fillestare
Initial Work Permit
Ripërtëritje e lejes së punës
Renovation of Work Permit
Azhurnim i lejes së punës
Adjournment of Work Permit
Dublikim i lejes së punës

Duplication of Work Permit

Shndërrim i lejes së punës

Conversion of Work Permit

Data e lëshimit të lejes së parë apo ekzistuese : _____
Issuing date of the first, of present Work Permit (datë, muaj, vit)
(day, month, year)

Data e përfundimit të lejes ekzistuese të punës : _____
Expiry date of the present Work permit (datë, muaj, vit)
(day, month, year)

SEKSIONI 5. TË DHËNA MBI PERSONIN/AT E KONTAKTIT
SECTION 5. CONTACT DETAILS

Telefon : _____

Telephone

Fax : _____

E-mail : _____

Web page : _____

Adresa aktuale : _____

Present Address

Rajoni/Qyteti : _____

Region/City/Town

Post Code/Zip Code : _____

SEKSIONI 6. TË DHËNA MBI VENDIN E PUNËS PËR PUNËMARRËSIN
SECTION 6. ABOUT THE JOB FOR THE EMPLOYEE

Emërtimi i vendit të punës

Job Title

Përshkrim i shkurtër i vendit të punës/Aftësi të përdorura/përgjegjësi
Short job description/Skills Used/Responsibilities

Ndërmarrja që punëson _____
Employing Company

Niveli i pagës : _____

Salary level

Data e menduar e fillimit të punës : _____

Intended start date of work

(datë, muaj, vit)

(day, month, year)

Data e menduar e përfundimit të punës : _____
Intended finish date of work (datë, muaj, vit)
(day, month, year)

Shpjegoni shkurtimisht se përse e keni pasur të vështirë të gjeni shtetas shqiptarë, apo rezidentë të huaj, të ligjshëm për zënien e këtij vendi të lirë pune?

Explain shortly why it is difficult to find someone from the resident labor market, or foreign legal resident for this vacancy?

Shpjegoni shkurtimisht se ç'këni bërë për të reklamuar (bërë publik, të njohur) këtë vend pune?

Explain shortly what have you done to publicly advertise this vacancy?

Jepni hollësira mbi njoftimet në internet dhe në median e shkruar, duke përfshirë edhe datat
Details about website and adverts in print publications including dates

Shpjegoni shkurtimisht se si mësuat për vendin e lirë të punës

Explain shortly how did the candidate employer find out about the vacancy?

(Për punëdhënësin) Shpjegoni shkurtimisht se si e zgjodhët kandidatin punëmarrës
(For the employer) Explain shortly how did you select potential employee?

Me njohje të drejtpërdrejtë

By direct acquaintance

Me rekomandim/referim

By recommendation/reference

Përmes listave të punëkërkesve pranë zyrës rajonale/vendore të punësimit

Consulting the lists of jobseekers at various Regional/Local Employment Offices

SEKSIONI 7. TË DHËNA PËR TË VETËPUNËSUARIN SECTION 7. ABOUT SELF-EMPLOYED

Person juridik

Legal Person/entity

Person fizik

Natural Person

Lloji i biznesit : _____

Type of Business

Kodi Fiskal/NIPT-i : _____

Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data regjistrimit : _____

Social Insurance Number and Date of Registration

(datë, muaj, vit)

(day, month, year)

Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit, ose : _____
Court Decision on Business Acknowledgment or
Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit : _____
Abstract from National Registration Centre

SEKSIONI 8. TË DHËNA PËR INVESTITORIN
SECTION 8. ABOUT THE INVESTOR

Person juridik
Legal person/entity

Person fizik
Natural Person

Lloji i biznesit : _____
Type of business

Kodi fiskal/NITPT-i : _____
Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data e regjistrimit : _____
Social Insurance Number and Date of Registration (datë, muaj, vit)
(day, month, year)

SEKSIONI 9. TË DHËNA TË PUNËDHËNËSIT
SECTION 9. ABOUT THE EMPLOYER

Person juridik
Legal person/entity

Person fizik
Natural Person

Lloji i biznesit : _____
Type of Business

Kodi fiskal/NIPT-i : _____
Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data e regjistrimit : _____
Social Insurance Number and Date of Registration (datë, muaj, vit)
(day, month, year)

SEKSIONI 10. KUALIFIKIME ARSIMORE
SECTION 10. EDUCATIONAL ATTAINMENT

1. Kualifikime arsimore
Educational Qualifications

Diplomë universiteti
University Diploma

Diplomë kolegji
College Diploma

Diplomë
Any Degree

Shkollë teknike
Technical School Diploma

Të përgjithshme
General Education Certificate

Të tjera
Others

2. Kualifikime të formimit profesional
Technical/Professional Training Qualifications

Certifikata/diploma
Certificates/Diplomas

Deklaroj se i lexova dhe rashë dakord (në një mendje) me kushtet për lëshimin e lejes së punës plotësisht i vetëdijshëm për pasojat e paraqitjes së të dhënave të rreme, apo jo të vërteta, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

I confirm that i have read and agree to the for the issue of the Work Permit well aware of the consequences for submitting false, or no real data according to prevailing Albanian legislation in force.

Tarifa për përpunimin dhe lëshimin e lejes së punës është...lekë shqiptarë, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr..... datë

The cost of processing is.....Albanian currency (lekë), as determined by the decision of the council of Ministers.....

(Emri, mbiemri)

Signature

____ / ____ /200 ____

VENDIM
Nr.31, datë 5.7.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 21.4.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.9 Akti që i përket:

KËRKUES: Marketin Topallaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, në mungesë
2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mungesë
3. Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mungesë

OBJEKTI:

1. Pranimi i padisë dhe shpallja si e papajtueshme me Kushtetutën e moslirimit të pronës.
2. Prishja e vendimit nr.00-2008-1033, datë 16.10.2008 të Gjykatës së Lartë.
3. Prishja e vendimit nr.656, datë 6.6.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Prishja e vendimit nr.1914, datë 6.4.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. Detyrimi i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë dhe i komisariatit përkatës të Policisë Tiranë për të liruar pronën truall 2000 m², të ndodhur në Mëzez (Tiranë), e cila është në pronësi të kërkuesit.

6. Detyrimi i Qeverisë Shqiptare për të dëmshpërblyer kërkuesin, për shkak të dëmit pasuror, të ardhur si pasojë e moslirimit të pronës së sipërpërmendur me vlerën prej 10.965 milionë euro.

7. Shfuqizimi i dispozitave të mëposhtme të nenit 128 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”: “Ligji nr.7498, datë 5.7.1991 “Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë” (i ndryshuar), si dhe akte të tjera normative në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e Policisë, por që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen”.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1,2, 42, 43, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe neni 1 i protokollit 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, kërkuesin, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi është pronar i një trualli prej 2000 m² të ndodhur në Mëzez (Tiranë). Në datën 24.2.1997 persona të tretë e zhveshën kërkuesin nga posedimi, duke mos e lejuar atë ta gëzonte sendin. Kërkuesi iu drejtua organeve të Policisë së Shtetit që, në përputhje me nenin 6 të ligjit

nr.7948, datë 5.7.1991 “Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë” (i ndryshuar), të ndërhyjnë për të mundësuar lirimin e pronës nga të tretët dhe vendosjen e saj në posedim të kërkuarit.

Duke qenë se organet e Policisë së Shtetit nuk vepruan, kërkuari iu drejtua me kërkesë-padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i kërkuar kësaj të fundit të detyronte organet përkatëse të Policisë së Shtetit që të vepronin në përputhje me ligjin e sipërcituar, për të mundësuar rivendosjen në posedim të kërkuarit.

Me vendimin nr.1914, datë 6.4.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rrëzoi padinë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Pas ankimit të kërkuarit, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.656, datë 6.6.2006, vendosi lënien në fuqi të vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas rekursit të bërë nga kërkuari në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit me vendimin nr.00-2008-1033, datë 16.10.2008 vendosi lënien në fuqi të vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në datën 16.9.2010 kërkuari i ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) kërkesën me objektin e mësipërm.

Kërkuari pretendon se gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë shkelur parimet e mëposhtme kushtetuese:

i) Parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur, për shkak se të dy gjyqtarët e caktuar për të gjykuar çështjen e kërkuarit ishin caktuar pa short.

ii) Parimi i pjesëmarrjes së palës në gjykim, pasi pala e paditur nuk ka qenë e pranishme gjatë gjykimit dhe se gjyqtarja M.Xh ka bërë bashkimin në një seancë të vetme prej 30 minutash të tri fazave të veçanta gjyqësore.

iii) Parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka kryer asnjë lloj hetimi gjyqësor, por ka pranuar si të mirëqenë variantin e palës së paditur, të cilin e ka përfituar në rrugë jashtëgjyqësore dhe, se si u tha më sipër, ka kryer vetëm një seancë prej 30 minutash, në të cilën ka përmbledhur tri faza gjyqësore.

iv) Parimi i një gjykimi të drejtë për shkak se gjykata ka keqinterpretuar dispozitat e ligjit nr.7948, datë 5.7.1991 “Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë” (i ndryshuar). Ka keqinterpretuar faktin nëse ky ligj është në fuqi apo jo, kur ka argumentuar se ligji nr.7948, datë 5.7.1991 “Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë” (i ndryshuar), është shfuqizuar nga ligji nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Gjithashtu, gjykata ka keqinterpretuar natyrën e kërkesë-padisë, duke argumentuar se kërkuari nuk mund të pretendonte ndërhyrje nga organet e Policisë së Shtetit, për arsye se, duke qenë se kishte një mosmarrëveshje civile me të tretët, duhet të ndiqte rrugën gjyqësore të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile.

II

1. Për pretendimin se është cenuar neni 42/2 i Kushtetutës, pasi gjyqtarët në të dyja nivelet e juridiksionit të zakonshëm janë caktuar pa short

Gjykata e shqyrton caktimin e gjyqtarit nëpërmjet shortit, në funksion të parimit të një gjykate të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, si një element thelbësor për një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor, i cili mënjanon paragjykimin e çështjes, rrit besimin e shtetasve të sistemi i drejtësisë dhe transparencën e këtij të fundit.

Në traditën e së drejtës kushtetuese europiane caktimi i gjyqtarit me short në kuadrin e të ashtuquajturit “gjyqtari natyral”, është zhvilluar si standard në lidhje të ngushtë dhe në respekt të parimeve që janë të shprehura në mënyrë eksplicite edhe në nenin 42/2 të Kushtetutës.

Në Republikën e Shqipërisë caktimi i gjyqtarëve me short bëhet nga kancelari i gjykatës, në përputhje me nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile dhe rregullat e vendosura nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Caktimi i gjyqtarit pa short, jashtë kriterëve të përcaktuara rigorozisht në ligj, në kuptim të respektimit të parimit kushtetues të një gjykate të caktuar me ligj, ngre probleme serioze kushtetutshmërie.

Duke pasur parasysh se besimi i qytetarëve të sistemi i drejtësisë është një nga elementet thelbësore të mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës, është e domosdoshme që gjykata të jetë dhe të shfaqet e paanshme në sytë e publikut të gjerë.

Debati në jurisprudencën dhe doktrinën europiane, nëse termi “gjykatë” kur flitet për gjykatë të caktuar me ligj, i takon vetëm gjykatës të identifikuar si organi kompetent për lëndë dhe territor për të zgjidhur çështjen konkrete dhe jo gjyqtarëve si persona fizikë është një problem, i cili është zgjidhur pikërisht nga neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile. Ky nen ka parashikuar se gjyqtari “natyral” për të zgjidhur çështjen konkrete, është ai që identifikohet, pasi është hedhur shorti dhe çdo procedurë e ndryshme ligjore jo vetëm do t’i binte ndesh ligjit, por do të ishte njëkohësisht në kundërshtim me standardin e sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës.

Standardi i gjykimit të shtetasve nga një gjykatë e caktuar me ligj është tashmë një standard i konsoliduar, si nga vendimet e kësaj Gjykate, ashtu edhe nga ato të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

Gjykata është shprehur se gjykimi i çështjes nga një gjykatë “e caktuar me ligj” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-së) (*shih vendimin nr.31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata ka theksuar, gjithashtu, në jurisprudencën e saj se e drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur, e të caktuar me ligj, kërkon, gjithashtu, që drejtësia jo vetëm të bëhet, por ajo duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr.31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, lipset që organet e administrimit të drejtësisë duhet të garantojnë transparencën dhe dokumentimin e të gjitha veprimeve të kryera.

Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese europiane, ndër vite, adoptuan disa kriterë themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t’i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete. Në këtë linjë është vlerësuar edhe nevoja e domosdoshme për caktimin e gjyqtarit me short për shqyrtimin e një çështjeje para se të bëhen publike rrethanat e çështjes dhe palët në gjykim. Vende të ndryshme përdorin metoda të ndryshme të hedhjes së shortit.

Në po të njëjtën linjë qëndron edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, sipas së cilës: “Një tribunal karakterizohet në kuptimin thelbësor të shprehjes nga funksioni i tij gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të përcaktuar. Ai duhet, gjithashtu, të kënaqë një numër kërkesash të mëtejshme, si: pavarësia, veçanërisht prej ekzekutivit; paanshmëria; qëndrueshmëria në detyrë e anëtarëve të tij; garancitë e ofruara nga procedura e tij, disa prej të cilave shfaqen edhe në vetë tekstin e nenit 6/1 të KEDNJ-së.” (*shih vendimin Belilos v. Zvicrës, datë 29.4.1988*). Për sa më sipër, procedurat, të cilave u referohet GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj, përfshijnë edhe procedurën e hedhjes së shortit.

Gjykata vëren se parimet e përcaktuara në nenin 42 të Kushtetutës nuk mund t’i referohen vetëm organit gjyqësor kompetent, në lëndë dhe territor, për të gjykuar një çështje të caktuar, por i referohen edhe gjyqtarit ose trupës gjyqësore, e cila investohet me zgjidhjen e çështjes konkrete. Në këtë kuptim, një procedurë jokorrekte në përcaktimin e gjyqtarit ose trupës gjyqësore nuk është në përputhje me Kushtetutën.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GJEDNJ-ja, e cila në një rast analog, ku kërkuesi pretendonte se i ishte cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 6 i KEDNJ-së, për arsye se gjyqtarët ishin caktuar pa short.

GJEDNJ-ja konstatonte në rastin e sipërpërmendur: “Gjithsesi, veçmas dështimit të dukshëm për të respektuar detyrimet që burojnë nga ligji për gjyqtarët popullorë (Lay Judges), Gjykata është veçanërisht e shtangur (struck) nga fakti se autoriteti i distriktit të Neklinovskiy-it (organi përgjegjës për caktimin e gjyqtarëve popullorë) ka konfirmuar se nuk kishte lista të gjyqtarëve popullorë, të caktuar para datës 4 shkurt të vitit 2000. Në këtë mënyrë autoritetet dështuan të paraqesin ndonjë

bazë ligjore për pjesëmarrjen e znj. Streblyanskaya dhe znj. Khovyakova në administrimin e drejtësisë në ditën e gjykimit të kërkuarit ...” (*shih vendimin Posokhov v. Ruisë e vitit 2003*).

Për sa më sipër, përfundimi që nxirret është se autoritetet shtetërore duhet jo vetëm të respektojnë kërkesat ligjore për hedhjen e shortit, por njëkohësisht duhet të dokumentojnë kryerjen e një procedure të tillë nga personat përgjegjës.

Gjykata i vlerëson pretendimet e kërkuarit në kuptim të përmbushjes të standardeve të mësipërme. Në kohën e shqyrtimit të çështjes gjyqësore procedura e hedhjes së shortit rregullohej me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.1830, datë 3.4.2001. Pika 4 e nenit 8 të tij detyronte kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit që të mbikëqyrnin procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe të nënshkruanin përcjelljen e çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar.

Nga shqyrtimi i materialeve të çështjes gjyqësore në ngarkim të kërkuarit, Gjykata konstaton se në vendimin e datës 8.12.2004 të Kryetarit të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi pranohej kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, në ngarkim të kërkuarit të gjyqtarës F.B., urdhërohej hedhja e shortit për caktimin e një gjyqtari tjetër. Gjykata vëren, gjithashtu, se në dosjen gjyqësore (kopertinë) gjendet nënshkrimi i nënkryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, krahas emrit të gjyqtarit që ngarkohej me shqyrtimin e çështjes. Gjykata konstaton se në vendimin e seancës përgatitore, gjyqtarja, që ka shqyrtuar çështjen, është shprehur se asaj i është ngarkuar çështja me short. Gjithashtu, Gjykata vëren se, pasi pala kërkuar ka marrë dijeni për caktimin me short të gjyqtarës, nuk ka ngritur asnjë pretendim në lidhje me shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes nga i njëjti gjyqtar.

Në seancën plenare të zhvilluar për këtë qëllim, kërkuari nuk arriti të paraqesë prova në mbështetje të pretendimeve të ngritura, se për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk është hedhur shorti për caktimin e gjyqtarëve.

Për sa më sipër, Gjykata krijon bindjen se në caktimin e gjyqtarëve, për të shqyrtuar çështjen e kërkuarit, është respektuar procedura e hedhjes së shortit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenim të parimit të gjykatës të caktuar me ligj, të parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës, duhet rrëzuar si i pambështetur në dokumentet e administruara në dosjen gjyqësore.

2. Për pretendimin se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë keqinterpretuar ligjin material dhe argumentet e paraqitura nga kërkuari

Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit për interpretim të gabuar të ligjit nr.7948, datë 5.7.1991 “Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë” (të ndryshuar) nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur në mënyrë të vazhdueshme, se interpretimi i ligjit material e procedural, si dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimin nr.14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr.31, datë 1.12.2005 dhe nr.22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për sa më sipër, Gjykata nuk është kompetente të shqyrtojë pretendime në lidhje me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe, për rrjedhojë, pretendimet e ngritura nga kërkuari dalin jashtë juridiksionit të saj.

3. Për pretendimin për dëmshpërblimin e dëmit jashtëkontraktor si pasojë e moslirimit të pronës nga ana e Policisë së Shtetit

Për sa i përket kërkesës për dëmshpërblimin e dëmit, Gjykata çmon se kjo kërkesë nuk është në kompetencë të saj, por të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se kërkime të kësaj natyre mund të paraqiten në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në bazë të dispozitave të Kodit Civil që kanë të bëjnë me

kompensimin e dëmit të shkaktuar, si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash (neni 450 i Kodit Civil). Vetëm pas ezaurimit të mbrojtjes juridiksionale, kërkuesi mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131/f, të Kushtetutës.” (shih vendimin nr.8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa për dëmshpërblim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.

4. Për pretendimin e cenimit të parimit të pjesëmarrjes në gjykim

Për sa i përket pretendimit të kërkuesit se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi pala kundërshtare nuk ka marrë pjesë në gjykim, Gjykata çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

Në përputhje me nenet 42/2, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës individët vënë në lëvizje Gjykatën për mbrojtjen e interesave të veta. Në rastin konkret kërkuesi pretendon se e drejta për të marrë pjesë në gjykim i është cenuar palës kundërshtare.

Duke qenë se kërkuesi nuk ka pretenduar një cenim të të drejtave të veta kushtetuese, por të të drejtave të të tretëve, ai nuk legjitimohet që të ngrejë këtë pretendim para Gjykatës.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.

5. Për pretendimin për cenim të parimit të paanshmërisë në gjykim

Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarja e vetme, gjatë gjykimit në shkallën e parë, nuk ka qenë e paanshme, pasi ka marrë të mirëqena provat e paraqitura nga pala tjetër dhe nuk ka kryer një hetim të plotë gjyqësor.

Gjykata në jurisprudencën e saj të konsoliduar është shprehur se vlerësimi i provave mbetet një çështje për t’u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrën e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit (shih vendimin nr.7, datë 27.4.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

Për sa më sipër, kërkesa, përderisa nuk ngre probleme lidhur me ligjshmërinë e marrjes së provave, por vetëm me pamjaftueshmërinë, si dhe me mënyrën e vlerësimit të tyre nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, është haptazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj

RREGULLORE
Nr.2638, datë 10.6.2011

MBI PAJISJEN ME LEJE VEPRIMTARIE TË TRANSPORTUESVE HEKURUDHORË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 6 dhe nenit 56 të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”:

duke adaptuar direktivat e Bashkimit European 95/18/KE, 2001/13/KE dhe 2004/49/KE të zbatueshme në transportin hekurudhor të udhëtarëve, mallrave dhe bagazheve;

me qëllim rregullimin, disiplinimin, monitorimin, transparencën e veprimtarisë së ushtruar ose që kërkohet të ushtrohet nga persona juridikë në fushën e transportit hekurudhor, si edhe integrimin gradual të tyre në tregun european të transportit hekurudhor, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit nxjerr këtë rregullore.

SEKSIONI I

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kriteret dhe procedurat që duhen zbatuar për dhënien, kohëzgjatjen, modifikimin, pezullimin dhe heqjen e lejeve të veprimtarisë të destinuara për transportuesit hekurudhorë ekzistues ose ata që do të krijohen në të ardhmen.

2. Nga fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje përjashtohen:

a) transportuesit hekurudhorë që kryejnë vetëm shërbime hekurudhore qytetëse dhe rrethqytetëse të udhëtarëve në infrastruktura hekurudhore lokale dhe rajonale autonome;

b) transportuesit hekurudhorë që kryejnë vetëm veprimtarinë e transportit hekurudhor të mallrave mbi një infrastrukturë hekurudhore private, që ekziston vetëm për shërbimet e transportit të mallrave të pronarit të infrastrukturës.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përdorur në të kanë kuptimin si më poshtë:

a) “Autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë” është autoriteti i ngarkuar për lëshimin e lejeve të veprimtarisë dhe/ose të operimit.

b) “Kërkuesi” është person juridik, publik ose privat (subjekti), që kërkon pajisjen me leje të veprimtarisë/leje të operimit.

c) “Leje veprimtarie” është një leje e dhënë nga autoriteti përkatës një subjekti, me anë të të cilit i njihet e drejta për të ofruar shërbime të transportit hekurudhor të mallrave dhe/ose udhëtarëve dhe bagazheve, për një periudhë të përcaktuar kohe, brenda ose jashtë vendit. Kjo cilësi mund të kufizohet me shfrytëzimin e disa llojeve të shërbimeve të transportit hekurudhor.

d) “Leje operimi” është dhënia e së drejtës transportuesve të huaj hekurudhorë për të ushtruar veprimtarinë e transportit ndërkombëtar hekurudhor në territorin shqiptar për lëvizjen e mjeteve të transportit hekurudhor që kanë vetëm stacionin e origjinës apo të destinacionit në territorin shqiptar.

e) “Ministria” është ministria përgjegjëse që mbulon veprimtarinë e transporteve në tërësi dhe që ka fushë të veprimtarisë bashkërendimin e drejtimit dhe kontrollin e veprimtarisë hekurudhore.

f) “Ministri” është personi përgjegjës për veprimtarinë e transportit, përfshirë dhe atë hekurudhor.

g) “Shërbim qytetës dhe rrethqytetës” është shërbimi i transportit hekurudhor, që i përgjigjet nevojave të një qyteti, si dhe nevojave midis këtij qyteti dhe komunave dhe fshatrave të të njëjtit rreth.

h) “Transportues hekurudhor” është çdo person juridik, publik ose privat, vendas apo i huaj, aktiviteti kryesor i të cilit është kryerja e shërbimeve të transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe/ose mallrave dhe që siguron vetë tërheqjen; ky term mbulon, gjithashtu, edhe transportuesit që sigurojnë vetëm tërheqjen.

i) “Transport i brendshëm hekurudhor” është transporti me hekurudhë i mallrave, udhëtarëve dhe bagazheve me itinerar që shtrihet tërësisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

j) “Transport ndërkombëtar hekurudhor” është transporti me hekurudhë i mallrave, udhëtarëve dhe bagazheve me itinerar të përshkruar nga treni i transportuesit hekurudhor, itinerar, i cili shtrihet pjesërisht në territorin tokësor të Republikës së Shqipërisë dhe që ka vetëm stacionin e origjinës ose të destinacionit në territorin shqiptar.

k) “Titullar” është personi juridik, publik ose privat (subjekti) që ka marrë një leje veprimtarie/leje operimi.

Neni 3

1. Lejet e veprimtarisë dhe lejet e operimit për ushtrimin e aktivitetit të transportit hekurudhor jepen nga ministria.

2. Drejtoria përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga kjo rregullore është drejtoria në ministri që mbulon aktivitetin e transportit hekurudhor.

SEKSIONI II KRITERET E MARRJES SË LEJES SË VEPRIMTARISË

Neni 4

1. Një person juridik, publik ose privat, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtën që të kërkojë një leje veprimtarie për të ushtruar aktivitetin e transportit hekurudhor.

2. Ministria nuk jep leje veprimtarie ose nuk zgjat afatin e vlefshmërisë së saj kur nuk plotësohen kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Një person juridik, publik ose privat, që plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje, ka të drejtën të pajiset me leje veprimtarie të transportuesit hekurudhor.

4. Asnjë person juridik, publik ose privat, nuk mund të kryejë shërbime të transportit hekurudhor që hyjnë në fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje nëse ai nuk ka një leje veprimtarie të përshtatshme për llojin e shërbimit në fjalë.

Megjithatë leja e veprimtarisë nuk i jep të drejtën që me të të hyjë në infrastrukturën hekurudhore.

5. Vlefshmëria e lejes së veprimtarisë është për të gjithë rrjetin hekurudhor kombëtar ose për një pjesë të tij për të cilën është paraqitur kërkesa për operim.

6. Në zbatim të nenit 2, pika 3 dhe të nenit 6, pika 3 të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, me kërkesë të transportuesit hekurudhor, atij i jepet leja e veprimtarisë për të ushtruar aktivitetin e transportit hekurudhor ndërkombëtar, pas nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse shtetërore mbi bazën e parimit të reciprocitetit, si dhe pas plotësimit të kriterëve të zbatueshme nga konventat ndërkombëtare për këtë lloj transporti.

Neni 5

Kushtet e përgjithshme të lejes së veprimtarisë

1. Çdo person juridik, publik ose privat, që kërkon marrjen e një lejeje veprimtarie i adreson një kërkesë të nënshkruar ministrisë, me postë rekomande ose me përgjigje të paguar.

2. Kërkesa paraqet:

a) tipin ose tipat e shërbimeve hekurudhore për të cilët kërkohet leja e veprimtarisë;

b) datën e parashikuar për fillimin e aktiviteteve të transportit hekurudhor.

3. Kërkesa për leje veprimtarie shoqërohet:

a) me dokumente që tregojnë që kërkuesi plotëson ose do të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

i) reputacionin e mirë;

ii) gjendjen e përshtatshme financiare;

iii) përmbushjen e kërkesave për kompetencën profesionale;

iv) zotërimin e mjeteve tërheqëse të transportit hekurudhor dhe të mjeteve të tjera për transportin e udhëtareve dhe të mallrave sipas gjendjes teknike të kërkuar nga rregullat dhe standardet teknike dhe të sigurisë;

b) me një fotokopje të aktit të vendimit të regjistrimit në Gjykatë ose në Regjistrin Kombëtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si dhe modifikimet e kryera;

c) me një fotokopje të vendimit të emërimit të paktën të një personi të caktuar, si drejtues veprimtarie, i cili plotëson kërkesat sipas nënpikave “i” dhe “iii” të pikës 3/a të këtij neni për të drejtuar efektivisht dhe vazhdimisht aktivitetin e transportit hekurudhor të personit juridik kërkuar. Ky person duhet të jetë rezident në Shqipëri.

4. Në zbatim të detyrimeve të paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, çdo person juridik, publik ose privat, që kërkon një leje veprimtarie për të ushtruar aktivitetin e transportuesit hekurudhor, duhet të japë të gjitha informacionet e nevojshme.

Neni 6

Plotësimi i kushtit të reputacionit të mirë

1. Personi juridik, publik ose privat, që bën kërkesë për pajisjen me leje veprimtarie për të ushtruar aktivitetin e transportuesit hekurudhor, duhet të garantojë që ai ose personat përgjegjës, të cilët menaxhojnë efektivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme operacionet e transportit hekurudhor kanë reputacion të mirë, pra:

a) nuk janë shpallur fajtorë me vendim gjykate në Shqipëri apo në vende të tjera për krime ose shkelje serioze ligjore, përfshirë aty dhe shkeljet e rënda të kryera në fushën tregtare;

b) nuk janë bërë objekt i një procedure falimentimi;

c) nuk janë shpallur fajtorë për shkelje të rënda në fushën e legjislacionit specifik të zbatueshëm në transportin hekurudhor;

d) nuk janë në proces hetimi apo gjykimi dhe nuk janë shpallur fajtorë për shkelje serioze ose të përsëritura të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i punës, legjislacioni i mbrojtjes në punë nga legjislacioni tatimor dhe as nga detyrimet që rrjedhin nga dispozitat doganore në rastin e një personi juridik që dëshiron të kryejë transport ndërkombëtar hekurudhor.

2. Kushti i reputacionit të mirë të personit juridik, publik ose privat, që bën kërkesë për pajisjen me leje veprimtarie, si dhe i personave përgjegjës, të cilët do të menaxhojnë efektivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme operacionet e transportit hekurudhor bëhet me vetëdeklarim, duke plotësuar formularët e aneksit 4 dhe 5 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3. Kërkesa për një reputacion të mirë konsiderohet e plotësuar edhe për personin ose personat që janë deklaruar të rehabilituar.

Neni 7

Plotësimi i kushtit për gjendjen e përshtatshme financiare

1. Kërkesat për gjendjen e përshtatshme financiare plotësohen kur kërkuesi paraqet dokumentacionin e duhur që ai disponon burime të mjaftueshme financiare, të cilat garantojnë përbalimin e aktivitetit të tij për një periudhë 12-mujore.

2. Për vlerësimin e gjendjes së përshtatshme financiare, çdo kërkesë për marrjen e lejes së veprimtarisë duhet të shoqërohet me bilancin vjetor të aktivitetit të personit juridik. Në rastin kur kërkuesi nuk mund të paraqesë bilancin vjetor, atëherë ai duhet të dokumentojë të dhëna të detajuara për aspektet e mëposhtme:

- a) fondet që disponon, duke përfshirë dispozitat bankare, kapacitetin huamarrës dhe kreditë;
- b) fondet dhe asetet, përfshirë pronat, të cilat personi juridik mund t'i lërë peng si garanci;
- c) kapitalin në përdorim;
- d) kostot përkatëse, duke përfshirë kostot e blerjeve dhe paradhëniet për automjetet, tokën, ndërtesat, instalimet dhe mjetet lëvizëse hekurudhore;
- e) detyrimet që rëndojnë mbi asetet e ndërmarrjes.

3. Në veçanti, subjekti kërkues duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur që ai nuk ka detyrime të prapambetura pranë administratës fiskale, që ka paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat kanë rezultuar nga aktiviteti i mëparshëm i tij.

4. Autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë mund të kërkojë paraqitjen e një raporti auditues nga një ekspert kontabël i autorizuar ose dokumente të përshtatshme nga një bankë. Këto dokumente mund të futen në dokumentacionin lidhur me çështjet e referuara në paragrafin 1.

5. Kërkuesi duhet të paraqesë planbiznesin e ndërmarrjes që mbulon vitin kur kërkohet leja e veprimtarisë, si dhe të paktën dy vitet vijuese. Ky plan duhet të ndajë qartë aktivitetet e transportit hekurudhor nga aktivitetet e tjera të ndërmarrjes.

Veçanërisht duhet të jepen:

- a) përshkrimi sasior dhe cilësor i produkteve dhe shërbimeve që do të ofrohen;
- b) përshkrimi i pasurive të tundshme dhe të patundshme, sidomos terrene, ndërtesa, linja hekurudhore, stacione, instalime të manovrës, të magazinimit etj., të cilat ndërmarrja i disponon ose do t'i disponojë;
- c) mjetet lëvizëse hekurudhore, të cilat ndërmarrja i disponon ose do t'i disponojë;
- d) një organigramë dhe një pamje tërësore e personelit në shërbim ose që do të angazhohet në të ardhmen, si dhe kualifikimet e tyre;
- e) të dhëna në shifra të të ardhurave dhe të kostove të parashikuara të ndërmarrjes për vitin në vazhdim, si dhe për dy vitet vijuese, duke i ndarë të ardhurat dhe kostot e parashikuara të aktivitetit të transportit hekurudhor nga të ardhurat e shërbimeve të tjera. Nëse këto nuk mund të evidentohen qartësisht atëherë të paraqiten të dhënat vijuese:
 - i) shuma vjetore e parashikuar për tarifën e përdorimit të infrastrukturës hekurudhore;
 - ii) vlerësimin e kostos vjetore mesatare për trenkilometër, duke specifikuar shpenzimet e mirëmbajtjes;
 - iii) investimet e parashikuara dhe financimi i tyre.

6. Ministria, në zbatim të legjislacionit kombëtar ose ndërkombëtar, mund të pranojë ose të kërkojë si provë me shkrim konfirmimin ose garancinë e lëshuar nga subjekti juridik me vetëdeklarim, që ai merr përsipër të mbulojë përgjegjësinë e tij civile në rast aksidenti, sidomos lidhur me udhëtarët, bagazhet, mallrat, postën, të tretët dhe administruesin e infrastrukturës hekurudhore. Kjo garanci pasurore, që përfshin kapitalin e vlefshëm ose rezerva financiare, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në transport". Për këtë qëllim subjekti plotëson formularin e vetëdeklarimit sipas aneksit 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Plotësimi i kushtit për kompetencën profesionale

1. Kërkesat për kompetencën profesionale plotësohen kur:

- a) Personi juridik që kërkon leje veprimtarie ka ose do të ketë organizimin e duhur, njohjen dhe/ose eksperiencën e nevojshme për të ushtruar operacionet e transportit hekurudhor dhe një mbikëqyrje të sigurt dhe efikase lidhur me tipin e operacionit të specifikuar në lejen e veprimtarisë.
- b) Ka drejtues veprimtarie, i cili plotëson kërkesat e mëposhtme:
 - i) reputacionin e mirë;
 - ii) të ketë përfunduar shkollën e lartë;
 - iii) të ketë një eksperiencë pune prej të paktën pesë vjetësh në fushën e transportit hekurudhor;

iv) jetë rezident në Shqipëri.

c) Personeli përgjegjës i lëvizjes së trenave dhe mjeteve hekurudhore ka një kualifikim plotësisht të miratuar në fushën e tyre të aktivitetit.

d) Personeli dhe organizimi janë të një natyre të tillë që u sigurojnë shërbimeve të kryera një nivel të lartë sigurie.

3. Respektimi i kërkesave të kualifikimit provohet nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve justifikuese korresponduese dhe të procedurave të parashikuara në ligjin nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 6 pika 2 dhe neneve 69-73 dhe të akteve nënligjore të hartuara në zbatim të tij.

4. Kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet kur kërkuesi provon zotërimin e njohurive të mjaftueshme juridike, tregtare, financiare dhe teknike për ushtrimin e veprimtarisë së transportit hekurudhor.

Neni 9

Plotësimi i kushtit për gjendjen e mirë teknike të mjeteve hekurudhore

1. Kërkesat për zotërimin e mjeteve tërheqëse të transportit hekurudhor dhe të mjeteve të tjera për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave sipas numrit dhe gjendjes teknike të kërkuar nga rregullat dhe standardet teknike dhe të sigurisë plotësohen kur kërkuesi ka siguruar inventarin e nevojshëm të mjeteve tërheqëse dhe të vagonëve hekurudhorë, të cilët janë në gjendje të mirë teknike dhe garantojnë zhvillimin normal të aktivitetit të transportit hekurudhor.

2. Gjendja e mirë teknike e mjeteve lëvizëse hekurudhore të transportit të brendshëm hekurudhor provohet kur ato plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloren “Për kushtet e pranimit teknik dhe të pranimit për shfrytëzim”, të hartuara në bazë të nenit 52 të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Konfirmimi i gjendjes së mirë teknike kryhet nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, sipas procedurave, standardeve dhe periudhave kohore të përcaktuara në rregulloren e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

3. Gjendja e mirë teknike e mjeteve hekurudhore që do të kryejnë transport hekurudhor ndërkombëtar, provohet kur ato plotësojnë të gjitha dispozitat e rregullave dhe të standardeve teknike ndërkombëtare, të detyrueshme për këtë lloj transporti.

SEKSIONI III

LËSHIMI, REFUZIMI, PEZULLIMI, HEQJA DHE MODIFIKIMI I LEJES SË VEPRIMTARISË

Neni 10

A) Lëshimi i lejes së veprimtarisë

1. Leja e veprimtarisë i jepet personit juridik kur ai plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në seksionin II (reputacioni i mirë, gjendja e përshtatshme financiare, kompetenca profesionale, zotërimi i mjeteve tërheqëse dhe lëvizëse hekurudhore në gjendjen e kërkuar teknike).

2. Leja e veprimtarisë dhe leja e operimit për ushtrimin e aktivitetit të transportit hekurudhor nuk mund të transferohet nga titullari i saj te një person tjetër juridik.

3. Në rast se personi juridik, titullar i një lejeje veprimtarie, ndryshon emrin, e vërtetuar kjo nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose me çdo dokument tjetër, me kërkesë të tij kryhet zëvendësimi përkatës i lejes së veprimtarisë me të njëjtin afat vlefshmërie dhe me një numër tjetër identifikimi, duke arkivuar dokumentacionin e vjetër.

4. Leja e veprimtarisë anulohet edhe me kërkesë të transportuesit hekurudhor, mbajtës i lejes, i cili duhet të paraqesë datën e ndërprerjes së veprimtarisë dhe arsyet e kësaj ndërprerjeje. Në këtë rast, autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë njoftohet zyrtarisht të paktën 2 muaj përpara.

5. Formatu tip i një lejeje veprimtarie është sipas aneksit 2 të kësaj rregulloreje dhe ka ngjyrë të kaltër.

B) Refuzimi i kërkesës për pajisjen me lejen e veprimtarisë.

1. Refuzimi i kërkesës për pajisjen me leje veprimtarie për ushtrimin e aktivitetit të transportuesit hekurudhor kryhet kur:

a) personi juridik që aplikon nuk plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në seksionin II (reputacioni i mirë, gjendja e përshtatshme financiare, kompetenca profesionale, zotërimi i mjeteve tërheqëse dhe lëvizëse hekurudhore në gjendjen e kërkuar teknike);

b) personi juridik që aplikon ka paraqitur dokumentacion jokorrekt në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e lejes së veprimtarisë;

c) personi juridik nuk plotëson kërkesat për rinovim të lejes së veprimtarisë të përcaktuara në këtë rregullore;

d) personi juridik që riaplikon në të kaluarën, ka kryer shkelje të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, të akteve nënligjore të transportit hekurudhor, si dhe akteve të tjera ligjore të parashikuara në legjisllacionin e punës, të sigurimeve shoqërore dhe të tatim-taksave.

2. Çdo refuzim i kërkesës për t’u pajisur me leje veprimtarie për ushtrimin e aktivitetit të transportit hekurudhor duhet të motivohet.

C) Pezullimi i lejes së veprimtarisë

Autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë mund ta pezullojë atë, duke ndërprerë për një periudhë të caktuar kohe veprimtarinë e transportuesit hekurudhor kur:

1. Pezullimi kërkohet me vendim gjykate, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

2. Ka informacione të besueshme dhe dyshime serioze që vazhdimi i veprimtarisë mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Pezullimi zgjat deri në verifikimin e informacioneve dhe marrjen e vendimit përfundimtar.

D) Heqja e lejes së veprimtarisë

Heqja e lejes së veprimtarisë kryhet nga autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë që e ka lëshuar atë kur:

1. Transportuesi hekurudhor, i pajisur me leje veprimtarie, nuk plotëson kriteret e përcaktuara në seksionin II (reputacioni i mirë, gjendja e përshtatshme financiare, kompetenca profesionale, zotërimi i mjeteve tërheqëse dhe lëvizëse hekurudhore në gjendjen e kërkuar teknike).

a) Në rastin e mosplotësimit të nenit 7 të kësaj rregulloreje (gjendja e përshtatshme financiare), transportuesit hekurudhor i jepet një afat deri në 12 muaj për të paraqitur një plan biznesi, që të vërtetojë se gjendja e tij financiare në të ardhmen do të jetë e mirë. Nëse autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë nuk bindet që ekziston mundësia realiste e ristrukturimit të kënaqshëm financiar, atëherë brenda 15 ditëve njofton transportuesin hekurudhor për heqjen e licencës.

b) Në rast mosplotësimi të nenit 8 të kësaj rregulloreje (kompetenca profesionale), atëherë transportuesit hekurudhor i jepet një afat deri në 3 muaj për zëvendësimin e punonjësve që nuk plotësojnë kushtet përkatëse të kompetencës profesionale dhe zëvendësimin e tyre me punonjës të tjerë.

2. Transportuesi hekurudhor e transferon lejen e veprimtarisë te një person tjetër juridik.

3. Transportuesi hekurudhor që zotëron një leje veprimtarie nuk respekton dispozitat e ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

4. Transportuesi hekurudhor, që zotëron një leje veprimtarie për transportin e udhëtarëve dhe të bagazheve, kryen shkelje të rënda lidhur me detyrimet e parashikuara për këtë shërbim në rregulloret përkatëse që kanë lidhje veçanërisht me realizimin dhe zbatimin e grafikut të lëvizjes së trenave, krijimin e kushteve të përshtatshme të komoditetit dhe të sigurisë në trenat e udhëtarëve, zbatimin e kontratës së transportit, trajtimi i bagazheve etj.

5. Transportuesi hekurudhor, që zotëron një leje veprimtarie kryen shkelje të përsëritura lidhur me sigurinë hekurudhore, gjendjen teknike të mjeteve tërheqëse e vagonëve, orëve të punës dhe të pushimit të drejtuesve të lokomotivave dhe të personelit tjetër shoqëruar të trenave, si dhe të kushteve të tjera që janë përshkruar në lejen e veprimtarisë.

6. Transportuesi hekurudhor, që zotëron një leje veprimtarie për transportin e udhëtarëve, nuk fillon aktivitetin brenda 60 ditëve nga data e marrjes së lejes së veprimtarisë, ose ndërpret aktivitetin për më shumë se 30 ditë në transportin e brendshëm dhe 15 ditë në transportin hekurudhor ndërkombëtar.

7. Kur transportuesi hekurudhor, që zotëron një leje veprimtarie për transportin e mallrave, ka ndërprerë aktivitetin e tij gjatë 6 muajve ose nuk ka filluar aktivitetin 6 muaj pas dhënies së lejes, atëherë autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë mund të vendosë që leja t'i hiqet dhe të bëhet objekt i një kërkesë të re miratimi.

E) Modifikimi i lejes së veprimtarisë

1. Nëse një transportues hekurudhor që zotëron një leje veprimtarie parashikon të modifikojë ose të zgjerojë aktivitetet e tij në mënyrë të konsiderueshme, atëherë leja e veprimtarisë duhet t'i nënshtrohet rishqyrtimit nga autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë.

2. Në rast modifikimi që prek situatën juridike të një transportuesi hekurudhor, sidomos në rastin e shkrirjes apo të marrjes së kontrollit, autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë mund të vendosë që leja duhet të bëhet objekt i një kërkesë të re miratimi. Transportuesi hekurudhor në fjalë mund të vazhdojë aktivitetin e tij transportues, të paktën për aq kohë sa autoritetit përgjegjës të lejeve të veprimtarisë i konfirmohet moscenimi i sistemit të sigurisë.

Neni 11

Pavlefshmëria e zëvendësimit i lejes së veprimtarisë

1. Leja e veprimtarisë është e pavlefshme kur:

a) i ka përfunduar afati;

b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:

i) emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;

ii) nënshkrimi i autoritetit përgjegjës të lejeve të veprimtarisë dhe vula përkatëse;

iii) data e fillimit dhe e përfundimit të periudhës së vlefshmërisë.

2. Zëvendësimi i lejes së veprimtarisë kryhet me kërkesë të titullarit të saj për rastet kur deklarohet e humbur, e vjedhur, e shkatërruar ose kur ka humbur vlefshmërinë sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni.

3. Transportuesit hekurudhor që kërkon zëvendësimin e lejes së veprimtarisë sipas paragrafit 2 të këtij neni, i jepet një leje e përkohshme veprimtarie njëmuajore nga autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë për vazhdimin e aktivitetit deri në kryerjen e verifikimeve të nevojshme. Leja e përkohshme lëshohet vetëm një herë.

4. Pas kryerjes së verifikimeve, lëshohet një leje tjetër veprimtarie me të njëjtën përmbajtje, por me një numër tjetër identifikimi.

5. Leja e përkohshme e veprimtarisë me afat njëmuajor për vazhdimin e aktivitetit jepet nga autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë edhe në rastet e rinovimit të lejes, kur vonesat në rinovim nuk janë përgjegjësi e kërkuarit dhe rrezikojnë ndërprerjen e aktivitetit.

Neni 12

Vlefshmëria e lejes së veprimtarisë

1. Leja e veprimtarisë është e vlefshme për një afat pesëvjeçar dhe brenda kësaj periudhe transportuesi hekurudhor duhet të plotësojë në vijimësi detyrimet e parashikuara nga kjo rregullore. Megjithatë autoriteti përgjegjës i lejeve të veprimtarisë rishqyrton plotësimin periodik të të gjitha kritereve të përcaktuara në seksionin II dhe të realizimit të sigurt të operacioneve të shfrytëzimit hekurudhor në intervale të rregullta prej dy vjetësh.

2. Leja e operimit, kur nuk ka një marrëveshje bilaterale në fuqi, është e vlefshme për një afat trevjeçar ose ka një kohëzgjatje në përputhje me afatin e përcaktuar në marrëveshjet dypalëshe shtetërore në fushën e transportit hekurudhor.

Neni 13

1. Përveç kritereve të përcaktuara nga kjo rregullore, transportuesi hekurudhor, gjithashtu, është i detyruar të zbatojë dispozitat e legjislacionit kombëtar dhe aktet nënligjore të nxjerra nga ministri, sidomos lidhur me:

- a) kërkesat teknike dhe operacionale specifike për shërbimet hekurudhore;
- b) kërkesat e sigurisë që zbatohen ndaj personelit, mjeteve lëvizëse dhe organizimit të brendshëm të transportuesit hekurudhor;
- c) dispozitat lidhur me shëndetin, sigurinë, kushtet sociale dhe të drejtat e punonjësve dhe të konsumatorëve;
- d) kërkesat e zbatueshme ndaj të gjithë transportuesve hekurudhorë në fjalë, të destinuara për të ofruar përparësi ose një mbrojtje ndaj konsumatorëve.

SEKSIONI IV PROCEDURAT PËR DHËNIEN E LEJEVE TË VEPRIMTARISË SË TRANSPORTEVE HEKURUDHORE

Neni 14

1. Dokumentacioni i plotë i përgatitur në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje për marrjen e lejeve të veprimtarisë për ofrimin e shërbimeve të transportuesit hekurudhor shqyrtohet dhe trajtohet nga sektori i licencimit të transportit në ministri, i cili ka të drejtën e komunikimit zyrtar me kërkuarësin për plotësimin e dokumentacionit e deri në marrjen e lejes së veprimtarisë.

2. Dokumentet quhen zyrtarisht të dorëzuara, duke filluar nga data që kërkuarësi i ka plotësuar ato në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe ato janë protokolluar në sektorin e licencimit të transportit. Ky sektor ka të drejtë të kërkojë dokumentacion plotësues për verifikim dhe jep të gjitha sqarimet e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm.

3. Data e dhënies së lejes së veprimtarisë është data e protokollimit të saj, pas nënshkrimit nga ministri ose nga personat e autorizuar prej tij.

4. Sektori i licencimit të transportit në ministri përgatit materialin për dhënie të lejes së veprimtarisë vetëm për ata persona juridikë, të cilët kanë plotësuar dokumentacionin sipas kërkesave të kësaj rregulloreje. Materiali i përgatitur për lejen e veprimtarisë kthehet në vendim pasi miratohet nga ministri. Vendimi bëhet në dy kopje.

5. Sektori i licencimit të transportit në ministri duhet t'i japë përgjigje subjektit për miratimin ose jo të kërkesës brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të dokumenteve.

6. Në rast se subjektit i refuzohet kërkesa për marrjen e lejes së veprimtarisë/lejes së operimit, atëherë atij i lind e drejta e ankimit të refuzimit brenda 15 ditëve pasi ai ka marrë njoftimin me shkrim për mosmiratimin e kërkesës. Ankimi bëhet me shkrim.

7. Ministria shqyrton ankimin e subjektit dhe del me një vendim brenda një muaji pas datës së depozitimit të ankimit.

8. Në rastin e mosveprimit nga ana e administratës (mosdhënien e përgjigjes), 3 muaj nga data e dorëzimit të dokumenteve, leja e veprimtarisë/leja e operimit konsiderohet e miratuar. Ministria duhet të pajisë subjektin me dokumentet e kërkuara.

Neni 15

Leje e operimit për subjektet e huaja të transportit për të operuar në rrjetin hekurudhor shqiptar

1. Subjekteve transportuese të shteteve të huaja të pajisura me lejen përkatëse të veprimtarisë në shtetin ku janë regjistruar, me të cilin është nënshkruar marrëveshje dypalëshe shtetërore në fushën e transportit hekurudhor, pas kërkesës që autoriteti kompetent i atij shteti i drejton autoritetit tonë përgjegjës të lejeve të veprimtarisë (Ministrisë) dhe pas marrjes së miratimit nga administruesi i

infrastrukturës hekurudhore për kapacitetet disponuese hekurudhore, Drejtoria e Licencimit në Ministri u lëshon lejen e operimit për territorin shqiptar.

2. Në raste të veçanta, leja e operimit lëshohet sipas procedurës së mësipërme edhe për subjekte të regjistruara në shtete të huaja, me të cilat nuk janë nënshkruar marrëveshjet përkatëse dypalëshe.

3. Format i lejes së operimit është sipas aneksit 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Dokumentacioni që subjekti do të duhet të paraqesë për pajisjen me leje veprimtarie për ushtrimin e aktivitetit të transportuesit hekurudhor është në aneksin I bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 17

Transporti i mallrave të rrezikshme brenda vendit

1. Veprimtaria e transportit hekurudhor të mallrave të rrezikshme brenda vendit ushtrohet nga transportuesit hekurudhorë që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre transportin e këtyre mallrave.

2. Punonjësit e subjektit juridik që do të merren me transportin e mallrave të rrezikshme duhet të kenë njohuri të plota mbi rregulloren për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, të hartuar në përputhje me pikën 2 të nenit 66 të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Subjekti, së bashku me dokumentet e tjera, paraqet vërtetimin e vetëdeklarimit, për plotësimin e njohurive të domosdoshme të rregullave të transportit dhe të trajtimit të mallrave të rrezikshme.

3. Subjektet juridike që kryejnë transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme, duhet të kenë në pronësi ose të kenë marrë me qira inventarin e duhur të mjeteve hekurudhore për këtë lloj transporti. Mjetet duhet të pajisen me certifikatën përkatëse nga ana e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor me anë të së cilës tregohet se ato plotësojnë kushtet e rregullores së transportit të mallrave të rrezikshme ose të RID-it.

4. Mjetet duhet të pajisen me certifikatën përkatëse nga ana e Institutit të Enëve nën Presion.

Neni 18

Dispozita përfundimtare

1. Për të pretenduar të drejtën e hyrjes në rrjetin hekurudhor shqiptar dhe për të ofruar shërbimet e transportit, çdo transportues hekurudhor duhet të posedojë lejen përkatëse të veprimtarisë, të lëshuar në bazë të kësaj rregulloreje.

2. Leja e veprimtarisë së transportuesit hekurudhor nuk i jep atij automatikisht të drejtën për të hyrë në rrjetin hekurudhor shqiptar.

3. Përveç lejes së veprimtarisë dhe në mënyrë që transportuesi hekurudhor që ka leje të mund të përdorë infrastrukturën hekurudhore duhet:

a) të disponojë një certifikatë sigurie, me anë të së cilës do të garantojë që ai ka krijuar sistemin e tij të administrimit të sigurisë dhe se do të përmbushë kërkesat e përmendura në specifikimet teknike të ndërveprimit ose në rregullat kombëtare të sigurisë me qëllim operimin e sigurt në rrjetin hekurudhor.

Certifikata e sigurisë do të lëshohet nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH), pas aplikimit të bërë nga ana e transportuesit hekurudhor.

Certifikata e sigurisë duhet të përmbajë:

i) pjesën A - që konfirmon pranimin e sistemit të administrimit të sigurisë së transportuesit hekurudhor, i cili duhet të jetë në përputhje me ligjin e sigurisë;

ii) pjesën B - që konfirmon pranimin e rregullave kombëtare/ndërkombëtare të sigurisë për kushte specifike të nevojshme për një transport të sigurt në rrjetin kombëtar nga ana e transportuesit

hekurudhor. Kushtet mund të përfshijnë rregullat kombëtare/ndërkombëtare të sigurisë, pranimin e certifikimit të personelit dhe konfirmimin e blerjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore që do të përdoren nga transportuesi.

b) DIH i lëshon certifikatën e sigurisë transportuesit hekurudhor vetëm pasi shqyrton dhe kontrollon dokumentacionin e plotë lidhur me:

i) krijimin dhe organizimin tërësor të sistemit të sigurisë së transportuesit hekurudhor;

ii) pajisjen e punonjësve me dëshmitë përkatëse të aftësisë profesionale;

iii) kontrollin e gjendjes teknike të mjeteve lëvizëse të transportuesit hekurudhor të licencuar, me qëllim që ato të plotësojnë rregullat kombëtare në fushën e sigurisë.

Formatet e certifikatës së sigurisë për pjesët A dhe B janë sipas formularëve të anekseve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje.

c) të lidhë kontratë me administruesin e infrastrukturës hekurudhore (ndërmarrjen për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore) për sigurimin e rrugëkalimeve në grafik të trenave që ai parashikon të lëvizë gjatë periudhës së vlefshmërisë së lejes së veprimtarisë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

ANEKSI 1
KËRKESAT E NEVOJSHME PËR MARRJEN E LEJES SË VEPRIMTARISË PËR KRYERJEN E
AKTIVITETIT TË TRANSPORTIT HEKURUDHOR

Nr.	Emërtimi	Kush e përgatit
1.	Kërkesa ku tregohet: a) tipi i shërbimeve të kërkuara: <input type="checkbox"/> transporti kombëtar i mallrave <input type="checkbox"/> transporti kombëtar i udhëtarëve <input type="checkbox"/> transporti ndërkombëtar i udhëtarëve <input type="checkbox"/> transporti ndërkombëtar i mallrave b) Data e parashikuar për fillimin e aktivitetit:	Subjekti juridik
2.	Reputacioni i mirë i subjektit: - Nuk janë shpallur fajtorë me vendim gjykatë në Shqipëri ose në vende të tjera. - Nuk janë bërë objekt i një procedure falimentimi. - Nuk janë shpallur fajtorë për shkelje të rënda në fushën e transportit hekurudhor. - Nuk jam në proces hetimi apo gjykimi, nuk jam shpallur fajtor për shkelje të detyrimeve të ligjit të punës, legjislacionit tatimor dhe doganor.	Subjekti juridik plotëson formularin e aneksit 4, ndërsa drejtuesi teknik plotëson formularin e aneksit 5 të autodeklarimit
3.	Gjendja e përshtatshme financiare: - Vërtetim mbi vlerësimin e gjendjes financiare (bilanci vjetor, fondet që disponon, përfshirë dispozitat bankare, kapacitetin huamarrës, kreditë; asetet duke përfshirë dhe pronat, të cilat personi juridik mund t'i lerë peng si garanci, kapitalin në përdorim, kostot e blerjeve dhe paradhëniet për automjetet, tokën, ndërtesat, instalimet dhe mjetet hekurudhore, detyrimet që rëndojnë mbi asetet e ndërmarrjes. - Vërtetim tip autodeklarimi që subjekti nuk ka detyrime të prapambetura ndaj administratës tatimore dhe se ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore, të cilat kanë rezultuar nga aktiviteti i mëparshëm. - Planbiznesi i aktivitetit të subjektit për vitin kur kërkohet licenca, si dhe për dy vitet pasuese, ku të ndahet aktiviteti i transportit hekurudhor nga aktivitetet e tjera. Veçanërisht të paraqiten:	Subjekti shoqëron kërkesën me vlerësimin e gjendjes financiare sipas kërkesave të parashtruara Subjekti plotëson këtë vërtetim Subjekti përgatit planbiznesin.

	<p>a) përshkrimi sasior dhe cilësor i produkteve dhe shërbimeve që ofrohen;</p> <p>b) një organigramë e organizimit të subjektit, e personelit në shërbim, si dhe kualifikimet e tyre;</p> <p>c) kostot e parashikuara për operim, të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti i transportit hekurudhor, të ndara nga aktivitetet e tjera. Nëse këto nuk mund të ndahen të paraqiten të dhënat vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shuma vjetore e parashikuar për tarifën e përdorimit të infrastrukturës hekurudhore. - Vlerësimi i kostos mesatare për trenkilometer, duke specifikuar shpenzimet e mirëmbajtjes. - Investimet e parashikuara dhe financimi i tyre. - Paraqitja e dokumentit që subjekti merr përsipër të mbulojë përgjegjësinë e tij civile në rast aksidenti, sidomos lidhur me udhëtarët, bagazhet, mallrat, të tretët dhe administruesin e infrastrukturës hekurudhore. Kjo garanci pasurore, që përfshin kapitalin e vlefshëm ose rezerva financiare, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në transport”. 	<p>Subjekti përgatit këto të dhëna për tre vitet e para të ushtrimit të aktivitetit</p> <p>Subjekti plotëson formularin e vetëdeklarimit sipas aneksit 3 të kësaj rregulloreje</p>
4.	<p>Dokumentacioni i kompetencës profesionale:</p> <p>a) Material ku të përshkruhet se subjekti ka ose do të ketë organizimin e duhur, njohjen dhe/ose eksperiencën e nevojshme për të realizuar operacionet e transportit hekurudhor dhe një mbikëqyrje të sigurt të tipit të operacionit të specifikuar në lejen e veprimtarisë.</p> <p>b) Personeli përgjegjës i lëvizjes dhe sigurisë së trenave ka kualifikimin e duhur në fushat e tyre të aktivitetit në përputhje me Kodin Hekurudhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.</p>	<p>Subjekti juridik paraqet materialin</p> <p>Subjekti juridik paraqet dokumentacionin justifikues të aftësisë profesionale (dëshmitë e aftësisë dhe dokumente të tjera)</p>
5.	<p>Dokumentacioni për disponimin e mjeteve lëvizëse, si dhe gjendja e tyre teknike:</p> <p>a) Numri dhe tipi i lokomotivave në pronësi ose të marra me qira (paraqitja e dokumentacionit përkatës për çdo rast).</p> <p>b) Numri dhe tipi i vagonëve të udhëtarëve në pronësi ose të marra me qira (paraqitja e dokumentacionit përkatës për çdo rast).</p> <p>c) Numri dhe tipi i vagonëve të mallrave në pronësi ose të marra me qira (paraqitja e dokumentacionit përkatës për çdo rast).</p> <p>d) Gjendja e mirë teknike e mjeteve lëvizëse në përputhje me plotësimin e rregullave kombëtare dhe ndërkombëtare (vërtetim i lëshuar nga DIH).</p> <p>e) Regjistrimi i tyre në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve (vërtetim i lëshuar nga DIH).</p>	<p>Ky dokumentacion paraqitet nga subjekti që kërkon lejen e veprimtarisë</p>
6.	<p>Fotokopje të noterizuar të aktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.</p>	<p>Paraqitet nga subjekti juridik</p>
7.	<p>Fotokopje të noterizuar të vendimit të emërimit të paktën të një personi të caktuar për të drejtuar efektivisht dhe vazhdimisht aktivitetin e transportit hekurudhor (drejtues teknik).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë. - Dokument për eksperiencën e punës mbi 5 vjet në fushën e transportit hekurudhor (dokumenti lëshohet nga HSH-ja). - CV e drejtuesit teknik. 	<p>Ky dokumentacion përgatitet nga subjekti</p>
8.	<p>Çdo dokument tjetër të kërkuar nga autoriteti që lëshon licencat</p>	

ANEKSI 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
 DREJTORIA E LICENCIMIT



LEJA E VEPRIMTARISË
 PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT HEKURUDHOR

Nr. ____, datë __/__/__

1. Shteti lëshues i lejes së veprimtarisë

Shteti lëshues:	<input type="checkbox"/> licencë e re <input type="checkbox"/> licencë e modifikuar
Numri i lejes kombëtare të veprimtarisë:	Identifikimi i vendimit
Legjislacioni i zbatuar:	
Autoriteti përgjegjës i lejes së veprimtarisë:	Nr. i telefonit:
Adresa postare:	Nr. i faksit:
Kodi postar dhe qyteti	Adresa elektronike

2. Titullari i licencës

Transportuesi hekurudhor:	Nr. i telefonit:
Adresa postare	Nr. i faksit:
Kodi postar dhe qyteti	Adresa elektronike:
Nr. i regjistrimit	Nr. i NIPT:

3. Vlefshmëria

E vlefshme duke filluar nga: deri në	
Tipi i shërbimit	Licence e përkohshme: <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO
<input type="checkbox"/> mallra <input type="checkbox"/> udhëtarë	Nëse PO: e vlefshme deri në:
Pezulluar me:	Tërhequr më:

4. Modifikime

Modifikuar më:
Përshkrimi i modifikimit

	Data
	Nënshkrimi
	Emri:

Shënim. Kjo leje veprimtarie lëshohet në baze të nenit 10, A) pika 5 të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA E ANEKSIT 2

INVENTARI I MJETEVE HEKURUDHORE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
TRANSPORTIT HEKURUDHOR NGA ANA E TITULLARIT TË LEJES SË VEPRIMTARISË

	Lloji i mjetit lëvizës	Tipi	Numri	Në pronësi apo me qira
I.	Lokomotiva			
II.	Vagonë udhëtarësh			
III.	Vagonë mallrash			

ANEKSI 3

FORMULARI I AUTODEKLARIMIT
PËR SUBJEKTIN QË KËRKON LEJE VEPRIMTARIE
LIDHUR ME MBULIMIN E PËRGJEGJËSISË CIVILE NË RAST AKSIDENTI, SIDOMOS
LIDHUR ME UDHËTARËT, BAGAZHET, MALLRAT, POSTËN, TË TRETËT DHE
ADMINISTRUESIN E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Unë i nënshkruari _____, pronar i veprimtarisë së shoqërisë _____, me seli në _____, deklaroj se jam banues në adresën _____, tel fiks: _____, cel: _____ dhe me dokument identifikimi nr. i letër njoftimit /pasaportës _____

Deklaroj se shoqëria _____, e regjistruar në QKR me NUIS/NIPT me nr. _____, datë _____, ndryshuar me nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie për të cilin kërkoj të më jepet leja e veprimtarisë.

do të mbuloj të gjitha përgjegjësitë civile në rast aksidenti, sidomos lidhur me udhëtarët, bagazhet, mallrat, postën, të tretët dhe administruesin e infrastrukturës hekurudhore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në transport”.

DEKLARUESI

Vetëdeklarim i nënshkruar nga titullari i subjektit që kërkon të licencohet

Emër, mbiemër, firmë, vulë

Datë ____ / ____ / ____

Shënim. Ky aneks lëshohet në bazë të nenin 7, pika 6 e kësaj rregulloreje.

ANEKSI 4

Datë, më _____

FORMULARI I AUTODEKLARIMIT
PËR SUBJEKTIN QË KËRKON LEJE VEPRIMTARIE

(drejtuar autoritetit kompetent ku bëhet aplikimi)

Unë i nënshkruari _____, administrator/ pronar/ drejtues i veprimtarisë së shoqërisë (*) _____ me seli në _____ deklaroj që jam banues në adresë _____ tel. _____ cel. _____ dhe me dokument identifikimi/ nr. pasaportës _____.

Deklaroj që shoqëria _____ e regjistruar në QKR me NUIS / NIPT me nr. _____, datë _____, ndryshuar me nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie aktiviteti për të cilin kërkoj të licencohem nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj të tretëve (Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve, Doganave, Organeve të Pushtetit Vendor).

Deklaroj që nuk jam në proces hetimi dhe as në proces gjyqësor, nuk jam shpallur fajtor në Shqipëri apo në vende të tjera për krime ose shkelje serioze ligjore, përfshirë shkelje të ligjit të punës, mbrojtjes në punë, legjislacionit specifik të zbatueshëm në transportin hekurudhor.

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Kërkoj të pajisem me leje veprimtarie për aktivitetin e transportit hekurudhor:

- kombëtar të udhëtarëve
- ndërkombëtar të udhëtarëve
- kombëtar të mallrave
- ndërkombëtar të mallrave
- në të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar
- në linjën hekurudhore _____

Deklaroj në përgjegjësinë time të plotë se: Të gjitha deklaramet e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

DEKLARUESI

Vetëdeklarim i nënshkruar nga titullari i subjektit që kërkon të licencohet

(emër, mbiemër, firmë, vulë)

Shënim. Ky formular plotësohet në zbatim të nenit 6, pika 2 e kësaj rregulloreje.

ANEKSI 5

Datë, më _____

FORMULARI I AUTODEKLARIMIT
PËR DREJTUESIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT

(drejtuar autoritetit kompetent ku bëhet aplikimi)

Unë i nënshkruari _____ deklaroj që jam banues në adresë _____ tel. _____ cel. _____ dhe me dokument identifikimi/nr. pasaportës _____:

Deklaroj që jam drejtues veprimtarie i shoqërisë së transportit _____ me seli në _____ me objekt veprimtarie _____, e cila kërkon të licenohet.

Deklaroj që jam i punësuar si drejtues veprimtarie në shoqëritë;

- _____
- _____

Deklaroj që nuk jam në proces hetimi dhe as në proces gjyqësor, nuk jam shpallur fajtor për shkelje të ligjit të punës, legjislacionit të transportit dhe në veçanti për shkelje të rregullave lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit për drejtuesin e mjetit.

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Deklaroj në përgjegjësinë time të plotë se: Të gjitha deklaratimet e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

DEKLARUESI

Vetëdeklarim i nënshkruar nga drejtuesi i veprimtarisë së transportit

(emër, mbiemër, firmë, vulë)

Shënim. Ky formular plotësohet në zbatim të nenit 6, pika 2 e kësaj rregulloreje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 Republic of Albania
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 Ministry of Public Works and Transport
DREJTORIA E LICENCIMIT
 Directorate of Licences

LEJE OPERIMI

Permit of operation

Nr. _____, datë ____/____/____
 No _____, date ____/____/____

PËR TRANSPORT NDËRKOMBËTAR HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE E TË MALLRAVE
 (for the international carriage of passengers and freight by train)

Mbajtësi i këtij autorizimi (the holder of this permit of operation),

Emri i shoqërisë së transportit: _____,

Full name or business name of the carrier

Me seli në: _____,

Trade address

Është i autorizuar të kryejë transport ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve dhe të mallrave midis Shqipërisë dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas kushteve të vendosura në marrëveshjen bilaterale për transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe sipas kushteve të vendosura në këtë leje operimi.

Is authorized to carry out international carriage of passengers and freight by rail between Albania and , in territory of the Republic of Albania pursuant to the conditions laid down on bilateral agreement and in accordance with the general provisions of this permit of operation.

Linja hekurudhore:
 Railway Journey

Stacioni i nisjes:
 Departure's station

Stacioni i mbërritjes:
 Destination's station

Leja e operimit është e vlefshëm nga ____/____/____ deri më ____/____/____.
 The permit of operation is valid from _____ until _____.

 Firma dhe vula
 Signature and Stamp
 e autoritetit kompetent
 of the Competent Authority

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
GENERAL PROVISIONS

1. Një kopje e lejes së operimit mbahet në bordin e trenit gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet menjëherë organeve të autorizuara të kontrollit me kërkesën e tyre.

(A copy of the permit of operation must be kept on board of the train throughout the journey and be produced whenever required by any authorized inspecting body).

2. Autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi i tij te një tjetër.

(The permit of operation is not transferable from its holder to another).

ANEKSI 7

CERTIFIKATA E SIGURISË PJESA A

Nr. _____, datë _____

Certifikata e sigurisë (pjesa A) konfirmon pranimin e sistemit të administrimit të sigurisë së transportuesit hekurudhor, i cili duhet të jetë në përputhje me ligjin e sigurisë;

1. Transportuesi hekurudhor i certifikuar

Statusi juridik:	
Emri i transportuesit hekurudhor:	Sigla:
Nr. i NIPT-it	

2. Organizata që lëshon certifikatën

Organizmi: Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
Shteti: Shqipëri

3. Informacione lidhur me certifikatën

<input type="checkbox"/> certifikatë e re <input type="checkbox"/> certifikatë e rinovuar <input type="checkbox"/> certifikatë e përditësuar <input type="checkbox"/> certifikatë e modifikuar	Nr. i identifikimit të certifikatës së mëparshme:
E vlefshme nga:	deri në:
Tipi (tipat) e shërbimeve:	<input type="checkbox"/> Transport kombëtar i i udhëtarëve <input type="checkbox"/> Transport ndërkombëtar i udhëtarëve <input type="checkbox"/> Transport kombëtar i mallrave <input type="checkbox"/> Transport ndërkombëtar i mallrave <input type="checkbox"/> Transport i mallrave të rrezikshme
Volumi i transportit:	<input type="checkbox"/> të paktën ____ tren-km në transportin e udhëtarëve <input type="checkbox"/> të paktën ____ tren-km në transportin e mallrave
Madhësia e transportuesit hekurudhor:	<input type="checkbox"/> transportues i madh <input type="checkbox"/> transportues i vogël

4. Legjislacioni kombëtar i zbatueshëm

Dosja e kërkesës është shqyrtuar mbi bazën e ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, të rregullave, rregulloreve dhe udhëzimeve aktualisht në fuqi.

5. Informacione plotësuese

--

Data e lëshimit:

DREJTORI
Emri, mbiemri

Vula e organit lëshues

Shënim. Ky formular plotësohet në zbatim të nenit 18, pika 3/b të kësaj rregulloreje.

ANEKSI 8

CERTIFIKATA E SIGURISË PJESA B

Nr. _____, datë ____ / ____ / _____

Certifikata e sigurisë (pjesa B) që konfirmon pranimin e klauzolave të miratuara nga transportuesi hekurudhor për të arritur kërkesat specifike të nevojshme për të qarkulluar me të gjithë sigurinë e duhur në rrjetin e dhënë, konform direktivës 2004/49/KE dhe të legjislacionit kombëtar në fuqi.

1. Transportuesi hekurudhor i certifikuar

- Statusi ligjor: (p.sh. shoqëri anonime)	
- Emri i transportuesit hekurudhor:	Sigla:
- Numri i NIPT-it	

2. Organizmi që lëshon certifikatën

Organizmi: Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
Vendi: Shqipëri

3. Informacione lidhur me certifikatën

<input type="checkbox"/> certifikatë e re <input type="checkbox"/> certifikatë e rinovuar <input type="checkbox"/> certifikatë e përditësuar <input type="checkbox"/> certifikatë e modifikuar	Nr. i identifikimit të certifikatës së mëparshme:
E vlefshme nga:	deri në:
Tipi (tipat) e shërbimeve:	<input type="checkbox"/> Transport kombëtar i udhëtarëve <input type="checkbox"/> Transport ndërkombëtar i udhëtarëve <input type="checkbox"/> Transport kombëtar i mallrave <input type="checkbox"/> Transport ndërkombëtar i mallrave
Volumi i transportit:	<input type="checkbox"/> të paktën ____ tren-km në transportin e udhëtarëve <input type="checkbox"/> të paktën ____ tren-km në transportin e mallrave

4. Certifikata e sigurisë – pjesa a (pranimi i sistemit të administrimit të sigurisë)

Numri i identifikimit europian:

5. Linjat e rezervuara

Kjo certifikatë është e vlefshme:
<input type="checkbox"/> për të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar
<input type="checkbox"/> për linjën hekurudhore

6. Kushte dhe detyrime specifike

Certifikata e sigurisë, pjesa B, lëshohet në bazë të elementeve të përshkruar në dosjen e kërkesës të përgatitur në bazë të ligjit nr. _____, datë _____ “Për sigurinë hekurudhore”, të udhëzimit përkatës, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji, si dhe të rregullores për pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhorë. Kjo certifikatë është e vlefshme në kufijtë e elementeve të përshkruar në dosje për aq sa këto elemente të mos modifikohen në mënyrë sinjifikative dhe të mbeten në konformitet me legjislacionin aktual në fuqi. Transporti i mallrave të rrezikshme i nënshtrohet një marrëveshjeje paraprake me autoritetet kompetente të caktuara për këto fusha.
--

7. Legjislacioni kombëtar në fuqi

Dosja e kërkesës shqyrtohet mbi bazën e ligjeve, vendimeve rregulloreve dhe udhëzimeve lidhur me sigurinë e shfrytëzimit hekurudhor dhe të atyre që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme
--

Data e lëshimit

Nënshkrimi
Emri, mbiemri
Drejtor

Vula e autoritetit lëshues

Shënim. Ky formular plotësohet në zbatim të nenit 18, pika 3/b të kësaj rregulloreje.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 18.7.2011
Doli nga shtypi më 20.7.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë